



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 3
Prishtinë, më 13.01.2015, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

Në mbledhje morën pjesë: Daut Haradinaj- kryetar, Bojan Mitiq, zëvendëskryetar i dytë, Anton Quni, Nuredin Ibishi, Zafir Berisha dhe Qerim Bajrami-anëtarë.

Munguan:Fadil Demaku dhe Ganimete Musliu.

Pjesëmarrësit nga Ministria e MPB-së: Naim Shala-Departamenti Ligjor, Ismet Zymberi-këshilltar politik i Ministrit, dhe Fatos Makolli- Departamenti anti-terrorizëm-Policia e Kosovës.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Naim Hajdari-EULEX, Skender Perteshi-QKSS, Visar Rushiti-GAP dhe Lejla Selimi-OSBE.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku dhe Zarife Aliu.

Mbledhjen e kryesoi: Daut Haradinaj, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit të mbajtur më 30.12.2014;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr. 05/L-02 për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit të mbajtur më 30.12.2014

Kryetari konstatoi miratimin e procesverbalit të mbledhjes të Komisionit të mbajtur më 30.12.2014.

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr. 05/L-02 për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit

Kryetar- Në këtë pikë të rendit të ditës i njoftoi anëtarët e Komisionit se projektligji ka ardhur nga Ministria e Punëve të Brendshme, gjithashtu prezent janë edhe përfaqësuesit e MPB-së dhe Policisë së Kosovës, pasi Projektligji është në lexim të parë do të kërkoja që këtij projektligji t'i japim mbështetjen në parim. Fjalën ia dha z. Bojan Mitiq, zëvendëskryetar i Kuvendit.

Bojan Mitiq- Theksoi se ka pasur pak kohë për të analizuar projektligjin, pasi dje pas dite e ka marrë tekstin e përkthyer, mirëpo e mbështet në parim këtë projektligj.

Anton Quni- Theksoi që ky projektligj edhe në legjislacionin e kaluar është shqyrtuar, por për shkak të rrethanave nuk është proceduar. Atëherë dhe tani, si përfaqësues i LDK-së e përkrah në parim këtë projektligj, pasi ka të bëjë me mbrojtjen e interesit shtetëror dhe sigurisë kombëtare. Gjatë procedimit të këtij projektligji do t'i adresojmë paqartësitë që i kemi të përbashkëta, gjithashtu edhe nga ana e zyrtarëve të MPB-së, do doja të kishim informata se ku janë referuar, në çfarë praktika dhe cila është ekspertiza në këtë fushë dhe a do të kemi gjatë shqyrtimit të këtij projektligji ndonjë ekspertizë shtesë?

Zafir Berisha- Tha se pajtohet që Kosova të ketë një ligj të kësaj natyre, por që ka disa vërejtje. Duke filluar në nenin 1 të këtij projektligji që flet për qëllimin, vlerësoi se duhet të jetë më i precizuar, kur theksohet mos pjesëmarrja e qytetarëve në luftëra, pasi vlerësoi se rrethanat në të cilën është iniciuar ky projektligj do të duhej që në nenin e parë të kishte të precizuar pjesëmarrjen në luftëra okupuese, agresive dhe organizata terroriste, pra të specifikohet në detaje që mospjesëmarrja e qytetarëve mund të ndodhë kur mekanizmat ndërkombëtarë japin qëndrim për x luftën e për x vendin.

Këtë qëndrim do të mbroj edhe në parlament dhe shpresoj të kem mirëkuptim, në mënyrë që bashkë me sponsoruesit të nxjerrim një ligj të qëndrueshëm.

Qerim Bajrami- Theksoi se si përfaqësues i grupi 6+ në këtë Komision, e ka lexuar këtë projektligj dhe pas analizimit të tij e mbështet këtë projektligj, gjithashtu do ta mbështesim edhe në Kuvendin e Kosovës. Kërkoi një sqarim nga përfaqësuesit e MBP-së për nenin 3 të Projektligjit, paragrafi 7. Sipas vlerësimit të tij ky paragraf është shumë i gjerë pasi nuk përcaktohet se kush e vlerëson këtë lirim ose dënim?

Nuredin Ibishi- Vlerësoi se për këtë projektligj ka dy çështje, theksoi se në nenin 2 të këtij projektligji, nga paragrafi 1 deri në paragrafin 7, si dhe në disa projektligje është anashkaluar Kodi Penal i Republikës së Kosovës. Prandaj mendoj se duhet të bëhet plotësim-ndryshimi i Kodit Penal, siç janë disa praktika p.sh. Shqipëria.

Ndërsa çështja tjetër, thirrja në konventa ndërkombëtare, siç është Konventa e Gjenevës, Protokollin 1, neni 47 që i referohet mercenarëve, edhe pse është përshkruar pak në Memorandumin shpjegues të këtij projektligji, nuk është e mjaftueshme, pasi ka dokumente dhe instrumente të tjerë ndërkombëtarë që përcaktojnë pjesëmarrjen në konflikte të armatosura dhe jo vetëm mercenarët.

Prandaj vlerësoi se kur të përgatitet projektligji final të jetë i gjithëpërfshirës, në mënyrë që mos të jetë një pjesë e pa mbuluar. P.sh. siç është indoktrinimi, aspekti ideologjik, aspekti politik etj. duhet të përmenden, në mënyrë që të parashihen në ligj.

Kryetari- Pasi projektligji është në parim, nuk hymë në materie edhe pse është e dobët dhe meqenëse ky projektligj ka gjithsej 5 nene, na kufizon shumë në amendamentim, pasi nëse kalojmë mbi 49 për qind e projektligji i kthehet Qeverisë.

Nisur nga praktikat e rajonit, do të mund të bëhej amendamenti i Kodit Penal, p.sh. Shqipëria, por pasi situata siç u theksua edhe këtu është kontesti më shumë fetar. Gjatë procesit të amendamentimit do të harmonizojmë amendamentet pasi nuk kemi shumë hapësirë.

Pastaj shtoi se Komisioni nga legjislatura e kaluar ka bërë një punë të mirë, propozime që kanë mbet në tentativë pasi është shpërbërë Kuvendi, propozime të cilat do t'i shqyrtojmë.

Pasi situata është emergjente dhe se ky faktor është edhe në rajon, gjithashtu ky projektligj nuk e përcakton se cilën periudhë kohore po flasim, cilat elemente konkrete, pasi neni parë dhe neni dytë i këtij projektligji kanë kontradikta.

Para se të votojmë në parim këtë projektligj, propozoj që të dëgjojmë qëndrimet e përfaqësuesve të MPB-së.

Naim Shala, drejtor i Departamentit Ligjor nga MPB- Lidhur me pyetjen e paraqitur nga z. Quni, theksoi se ky projektligj është përgatitur në legjislaturën e kaluar, por për shkak të shpërbërjes së Kuvendit nuk ka kaluar leximin e dytë.

Ky projektligj është sponsorizuar nga Ministria e Drejtësisë, ndërsa sa i përket ndryshimit në Kodin Penal të Kosovës do të duhej që këtë ta bënte Ministria e Drejtësisë dhe do të duhej më shumë punë. Me këtë projektligj është bërë përcaktimi i një veprë penale, veprë e cila zbatuesve të ligjit u ka nxjerrë problem për përcaktimin dhe goditjen e veprës të kësaj natyre.

Ndërsa sa i përket përcaktimit të veprës, tha se ky projektligj nuk ka të bëjë me terrorizmin, pasi në Kodin Penal është i përcaktuar, por vetëm është bërë përcaktimi i një vepre penale kundër pjesëmarrjes në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit, pa përfshirë elementin fetar, por është marrë modeli i veprës penale dhe është përshtatur në këtë projektligj. Gjithashtu theksoi se në nenin dy të këtij projektligji përcaktohen rastet se kur përjashtohen, rastet me dy shtetësi, gjithashtu edhe te lartësia e dënimeve është marrë për bazë analogjia e veprës penale terroristë.

Pastaj shtoi se sa i përket pyetjes së parashtruar se cilat vende janë marrë si model, tha se e ka këtë model Bosnja, Shqipëria, Maqedonia dhe Serbia.

Kryetari- Duke iu referuar projektligjit tha se nëse lexojmë nenin 1 kuptojmë që bie në ndesh me nenin 2, ndërsa sa i përket modelit të Shqipërisë, e kanë adoptuar një model në Kodin Penal të Shqipërisë. Ju falënderoj si përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Brendshme për projektligjin e përgatitur, i cili ka mundur të jetë edhe më përmbajtjesor.

Zafir Berisha- Jemi të vetëdijshëm që ky projektligj është iniciuar nën ndikimi i situatës globale që po ndodh dhe vepra të tjera janë të sanksionuara nga ligje të tjera. Konsideroi se nuk është e domosdoshme krahasimi me vendet e rajonit, pasi çdo vend ka specifikat e veta.

Qëllimi i këtij projektligji dihet, që qytetarët të mos marrin pjesë në luftëra jashtë vendit, kryesisht në Lindje të mesme, gjithashtu duhet të dimë që me miratimin e këtij ligji nuk do të mund të kontrollojmë këtë fenomen. Por duhet të kemi mirëkuptim dhe bashkëpunim që ky projektligj ndikuar nga rrethanat historike, gjeografike dhe politike të përshtatet dhe duke mos u ndikuar nga praktikat e rajonit.

Nuredin Ibishi- Sa i përket personave me dy e më shumë shtetësi, theksoi se shpeshherë identifikimi i personit të caktuar bëhet se nga e ka prejardhjen, pavarësisht që ka shtetësi të dytë.

Naim Shala- Me këtë projektligj është synuar përcaktimi i veprës penale, dhe kjo vepër i ka format e kryerjes të cilat i kemi përfshirë në këtë projektligj. Ndërsa sa i përket dy shtetësisë, ky projektligj i referohet atyre qytetarëve që nisen nga Kosova, por jo nga vende të tjera që kanë shtetësinë e po atij vendi. Gjithashtu tha se është miratuar një Rezolutë nga Këshilli i Sigurimit më 24 shtator 2014, u jep mandat shteteve që të rregullojnë çështjen e veprave penale dhe ky projektligj është bërë edhe në frymën e kësaj rezolute.

Kryetari- Shtoi se për luftëra fetare është diskutuar edhe dje në Këshillin e Evropës, por ky projektligj nuk e sanksionon pjesëmarrjen në luftëra fetare, terroriste dhe radikale, duke tingëlluar si masë parandaluese.

Propozoi që pasi projektligji është i ndjeshëm, pjesë e grupit punues të jenë të gjithë anëtarët e Komisionit në mënyrë që të japin kontributin e tyre dhe nëse jeni dakord e hedhim në votim në parim projektligjin.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me vota unanime nxori këtë

Rekomandim

Të miratohen, në parim, Projektligji Nr. 05/L-02 për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit

I rekomandohet Kuvendit të Republikës së Kosovës miratimi në parim i këtij projektligji.

4. Të ndryshme.

Zafir Berisha- Lidhur me Projektligjin për përgjimin e telekomunikimeve, që është sponsorizuar nga Qeveria, konsideroi se është adresuar gabimisht, pasi ky projektligj i referohet AKI-së, policisë ndërkaq për shqyrtimin e tij është ngarkuar Komisioni për Integritet. Nëse si Komision lejohet që të bëhen kalkulime të tilla të bëhen.

Kryetari- Vlerësoi se kjo çështje është shqetësim real, gjithashtu edhe përfaqësuesit e Agjencisë për mbrojtjen e të Dhënave personale janë të pakënaqur me trajtimin e këtij ligji. Mundësia jonë si Komision është e kufizuar për të bërë ndryshime në këtë projektligj, vetëm mund të shprehim shqetësimet tona, ndërsa ky projektligj i është adresuar Komisionit për Integritet.

Nuredin Ibishi- Theksoi se ka një vërejtje, pasi nëse Projektligji për Përgjimet nuk kalon në Komisionin për Komunitete, Barazi Gjimore, Peticione, i cili në legjislaturën kaluar ka qenë komision i përhershëm, por që tani nuk është, pasi ky projektligj prek aspektin e të drejtave të njeriut, ndërsa çështja e integriteteve janë standarde që përshkruhen në memorandumin shpjegues të projektligjit.

Ky projektligj në draftin e parë është shumë i mangët, pasi i referohet Policisë së Kosovës, Agjencisë për Inteligjencë dhe jo agjencive të tjera.

Nëse Komisioni ynë dhe Komisioni për të Drejtat anashkalohet, ky projektligj do të jetë i mangët, pasi ky projektligj i referohet sektorit të sigurisë.

Kryetari- Kryesisht për këtë projektligj në legjislaturën kaluar ka pasur vërejtje të mëdha dhe ky projektligj nuk është mbështetur, dhe mbase këtë herë i është adresuar Komisionit për Integritet Evropian, si Komision më “atraktiv”. Por juridikisht si Komision nuk kemi të drejtë të ndërhyjmë.

Zafir Berisha- Theksoi se është e vërtetë që ka shmangieje për të kaluar këtë projektligj, por si përfaqësues të grupeve parlamentare, që i përkasim secili nga ne, do të duhej të përdorim autoritetin për këtë qëllim, që projektligji të jetë shkruar më i mirë. Nëse projektligji kalon si i tillë që është aktualisht, do të krijojë amulli sa i përket kontrollit parlamentar për zbatimin ligjit.

Qerim Bajrami- Shtroi pyetje e cila është adresuara nga prindërit dhe familjarët e të ndjerit Z. Sherifo Sefkovic, nga komuniteti boshnjak i cili është vrarë në një akt terrorist në vitin 2010, para zgjedhjeve në nivelin qendror në Kosovë.

Pastaj theksoi se deri tani nuk është bërë asgjë për zbardhjen e këtij rasti.

A është mundësia që ne, si Komision, të ndërmarrim ndonjë hap, ose ju si kryetar të pranoni familjen e tij?

Me iniciativën e komunitetit boshnjak ky person është shpallur hero i popullit, por që akoma nuk dihet se nga kush është vrarë.

Kryetari- Konsideroi se si Komision janë përgjegjësitë e kufizuara në këtë drejtim, ndërsa në të ardhmen e afërt kur do të jenë në raportim ministri i MPB-ë dhe drejtori i Policisë mund t'u bëhet pyetje për këtë rast. Si kryetar i Komisionit jam i gatshëm t'i takoj me kënaqësi, pra kjo çështje i takon drejtësisë.

Pastaj i njoftoi anëtarët e Komisionit që nga ana e OSBE-së, është ofruar një punëtori njëditore jashtë Prishtinës, dhe data e propozuar është 27 dhe 28 janar, ku qëllimi i saj është të analizohet plani i punës së Komisionit.

Nuredin Ibishi- Kërkoj që paraprakisht të përgatitet një raport i punës me OSBE-në që është bërë deri tani, dhe plani për vitin e ardhshëm që do të ofrojnë mbështetje.

Kryetari- Nëse nuk keni çështje të tjera për të ngritur, e konsideroi të mbyllur takimin.

Mbledhja përfundoi në orën 11:50.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Daut Haradinaj